



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:113806

Datë: 29.11.2024

Numri i dokumentit: 06528075

APS.nr.45/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – DEPARTAMENTI SPECIAL, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Burim Ademi – kryetar, Vaton Durguti dhe Kreshnik Radoniqi – anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gresë Latifi, në lëndën penale ndaj të akuzuarit Ç.J, për shkak të veprës penale Krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së, si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, duke vendosur lidhur me ankesën e mbrojtësit e të akuzuarit Ç.J-av. M.B., të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë -Departamenti Special, PS.nr.49/2022 të datës 22.06.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 04.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.Me aprovimin e ankesës së mbrojtësit të akuzuarit Ç.J-av.M.B., aktgjykimi Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Special, PS.nr.49/2022 i datës 22.06.2024, **AULOHET** dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

II.I akuzuari Ç.J mbetet nën masën e paraburgimit gjersa gjykata e shkallës së parë në rigjykim merr vendim tjetër.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special, me aktgjykimin PS.nr.49/2022 të datës 06.22.2024, të akuzuarin Ç.J e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Krime lufte kundër popullatës civile nga neni 142 e lidhur me nenin 22 të LP të RSFJ-së, si ligj në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, dhe e ka gjykuar me dënim me dërgim në kohëzgjatje prej tetë (8) vite, në të cilin dënim do t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim nga dt.2.06.2022 e deri sa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë.

Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 150 €, si dhe në emër të fondit të viktimave të krimit shumë prej 100€, të gjitha këto në afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

Të akuzuarit Ç.J me aktvendim të posaçëm i ka vazhduar masën e paraburgimit deri në plotfuqishmëri të këtij aktgjykimi.

Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike i ka udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar:

Mbrojtësi i të akuzuarit Ç.J-av. M.B., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe vendimit mbi dënimin dhe shpenzimet e procedurës penale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza apo lëndën ta kthej në rigjykim dhe rivendosje ose që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj përkitazi me vendimin mbi dënimin duke i shqiptuar një dënim më të butë.

Përgjigje në ankesën e mbrojtësit e të akuzuarit Ç.J-av.M.B., ka ushtruar prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me propozim që ankesa e mbrojtësit e të akuzuarit të hudhet si e pa bazuar ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Prokuroria e Apelit më parashtrës, PPA/I.nr.499/2024, të datës 11.09.2024, ka propozuar që të refuzohet ankesa e mbrojtësit e të akuzuarit Ç.J-av.M.B., si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet. Ndërsa të trajtohet si e bazuar përgjigja në ankesën e

mbrojtësit e të akuzuarit Ç.J-av. M.B., e parashtruar nga Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, PPS.nr.42/22 të datës 06.09.2024, ashtu që ankesa e paraqitur ndaj aktgjykimit, PS.nr.49/22 të datës 22.06.2024, të hudhet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-se në të cilën ishin prezentë përkthyesja e gjykatës M.H., të dëmtuarit Z.M, N.C, i akuzuari Ç.J dhe mbrojtësi i të akuzuarit av. M.B., ndërsa nuk ka prezantuar Prokurori i Apelit edhe pse i njëjti ka qenë i njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt për mbajtjen e seancës.

Gjykata e Apelit, analizoi aktgjykimin e ankimuar së bashku me shkresat e lëndës, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësit e të akuzuarit Ç.J-av. M.B., si dhe përgjigjen në ankesë e ushtruara nga PSRK dhe gjeti se: **ankesa është e bazuar.**

Pretendimet ankimore

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit Ç.J av. M.B. thekson se aktgjykimi i ankimuar është i parregullt dhe joligjor për arsyet në vijim: Para së gjithash duhet theksuar se, në pajtim me nenin 369 par.7 të KPP-së, gjykata ka për detyrë që në mënyrë të kjart dhe të plotë të skjaroj se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh, i konsideron si të provuara apo të paprovuara dhe ka obligim të vlerësoj vërtetësinë e provave kundërthënëse. Gjykata e shkallës së parë në rastin konkret ka vepruar pikërisht në kundërshtim me këtë dhe me këtë ka kryer shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par. 2 pika 7 të KPP-së e cila gjë ka ndikuar në (mos) marrjen e aktgjykimit ligjor dhe të drejtë. Mbrojtja tutje shton se edhe pse sipas pretendimit, veprën e ka kryer në bashkëkryerje me persona tjerë, gjykata e shkallës së parë në dispozitiv të aktgjykimit, në lidhje me këtë, nuk ka theksuar asnjë veprim specifik që ka ndërmarr i akuzuari, në mënyrë që në rastin konkret të mund të bëhet fjalë për bashkëkryerje. Shprehimisht, bashkëkryerja, si formë më e lartë e organizmit të kryerjes së veprës penale nga ana e më shumë personave, duhet të përshkruhet në petitumin e aktakuzës e me vetë këtë edhe në dispozitiv të aktgjykimit, si në aspektin e elementeve subjektive ashtu edhe atyre objektive. Ajo duhet të provohet në mënyrë ekzakte e jo të nxirren pasojat që kanë rrjedh apo ndodhur. Këtu as nuk ka dashje unike, as marrëveshje paraprake, as ndarje rolesh gjatë procesit të kryerjes së veprës, si elemente thelbësore pa të cilat bashkëkryerja nuk mund të ekzistoj. Veprimi konkret te secilit nga bashkëkryerësit duhet të përshkruhet veçmas dhe deri në imtësi, sepse nga kjo do të varet

vlerësimi i gjykatës se nëse ndonjë veprim i tillë ka kontribuar ose ka mundur të kontribuoj thelbësisht në procesin e kryerjes së veprës. Me fjalë tjera, vetëm ai bashkë kryes i cili ka ndërmarrë ndonjë veprim e cila ka mundur që thelbësisht të kontribuoj në kryerjen e veprës, mund të trajtohet si i tillë. Dispozitivi i aktgjykimit nën a) I akuzuari vetëm është përmendur si njëri prej 5 policëve serb i cili kishte dal nga shtëpia e Rosës, pas cilës gjë 2 policë (nuk ceket se cilët) kanë kapur të dëmtuarin Z.M për duarsh dhe kanë filluar t’ a rrahin dhe se në një moment polici D.P e ka goditur Z.M në kokë nga e cila goditje ai është alivanosur. Konkretisht çka dhe a ka bërë çka do qoftë me atë rast i akuzuari Ç.J kjo nuk precizohet? Duke pas parasysh se në arsyetimin e aktgjykimit gjykata ka vërtetuar që goditja kontestuese në kokë të dëmtuarit është plasuar nga i akuzuari Ç.J, kjo kjartazi është në kundërshtim me dispozitivin e aktgjykimit, sipas së cilit goditjen në kokë të dëmtuarit e bënë D.P, e jo Ç.J. Pasi kjartazi shihet se dispozitivi i aktgjykimit në këtë pjesë është në kundërshtim me arsyetimin e saj, kjo pa dyshim paraqet shkelje esenciale të procedurës e cila drejtpërdrejt ka ndikuar në ligjshmërinë e aktgjykimit, i cili si i tillë ligjërisht nuk mund të qëndroj. Dispozitivi i aktgjykimit nën b) Gjykata e shkallës së parë praktikisht ka përshkruar aktakuzën sipas së cilës 5 policë serb kanë hyrë në restorantin “Shija” në të cilin ishte i ulur dhe pinte kafe i dëmtuari N.F., se e kanë tërhequr (nuk thuhet kush) jashtë lokalit: që njëri prej tyre - R.P, shumë herë e ka goditur në kokë dhe në pjesë tjera të trupit me tytë të automatikut dhe se pastaj e kanë dërguar në stacion policor, dhe se i dëmtuari N.C e kishte parë atë incident sepse edhe atë poashtu e kishin rrahur i njëjti grup policësh. Kjo është në tërësi në kundërshtim me përmbajtjen e provave të administruara. Shprehimisht, vet i dëmtuari N.F me asnjë fjalë nuk ka përmendur të akuzuarin Ç.J, si pjesëmarrës në sulmin kundër tij, ndërsa i dëmtuari N.C, vetëm ka përmendur R.P. Kjo kundërthënie në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit po ashtu paraqet shkelje esenciale procedurale e cila ka ndikuar në ligjshmërinë dhe drejtësinë (e aktgjykimit). Dispozitivi i aktgjykimit nën c) Kjo pjesë e aktgjykimit ka të bëjë me të dëmtuarin N.C. E nënvizoj faktin që veprimet e përshkruara nga dispozitivi i aktgjykimit, të cilat kinse i ka kryer i akuzuari Ç.J bazohen ekskluzivisht në tregimin e të dëmtuarit, i cili nuk mundet e as që është dëshmitarë i besueshëm e as kredibil nga arsyeja e thjeshtë se për faktet e njëjta thelbësore ka dhënë deklaratat të ndryshme e të cilat së paku është dashur të vlerësohen detajisht dhe themelësisht që të mund të nxjerret konkluzë e sigurt se a e ka thënë të vërtetën N.C apo jo. Në vend se të merrej me atë problem, gjykata e shkallës së parë nga të gjitha tregimet/pohimet e tij ka marrë parasysh vetëm ato që kanë shkuar në favor të konkludimit se ai ishte sulmuar, mes tjerëve edhe nga ana e të akuzuarit Ç.J, e kjo nuk është në përputhje me ligjin, e as që është kompatible me provat e administruara. Gjykata e shkallës së parë deklaratat e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve në këtë lëndë, të cilat i kanë dhënë gjatë fazës së hetimeve ose në

seancën kryesore përgjithësisht i vlerëson si shumë bindëse dhe ndërsjelltas kompatible, dhe në bazë të kësaj përfundon se i akuzuari vërtetë ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Qëndrimi i këtillë i gjykatës së shkallës së parë është i papranueshëm, sepse nga provat mbi të cilat bazohet një aktgjykim dënues duhet të plotësohet standardi juridik se jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm shihet se i pandehuri me të vërtetë ka kryer veprën penale. Me fjalë tjera, provat duhet të jenë të kjarta, bindëse, e jo si provat në këtë lëndë, që janë plotësisht jo koherente, kundërthënëse mes vete, kundërthënëse karshi provave tjera, me vet këtë edhe jokredibile dhe jo të besueshme. Parimi in dubio pro reo, sikur të mos ekzistoj fare, sikur gjykata të mos ketë dëgjuar kurrë për të. Edhe pse në fjalën përfundimtare e kam lut gjykatën që deklaratat e të dëmtuarve ti vlerësoj me shumë kujdes, në tërësi dhe veçmas, e jo “COPA-COPA” (vetëm segmente të caktuara), gjykata ka vepruar krejtësisht ndryshe edhe pse teorikisht thekson se ka respektuar normat ligjore të cilat përshkruajnë se në çfarë mënyre duhet vlerësuar provat.

Përgjigje në ankesë

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës Kosovës në përgjigje në ankesën e mbrojtësit e të akuzuarit Ç.J av. M.B., ka theksuar se ankesa e mbrojtësit e të akuzuarit në përmbajtjen e saj ka të me vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për të cilën prokuroria konsideron se pretendimi i mbrojtjes së të pandehurit është i pabazuar sepse gjendja faktike është vërtetuar në bazë të deklaratave të dëshmitarëve dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, e që të gjithë dëshmitarët, si gjatë fazës së hetimeve ashtu edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor kanë vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit. Në rastin konkret dëshmitaret të drejtpërdrejtë të ngjarjeve të përshkruara në dispozitiv, ishin vet të dëmtuarit të cilët hynë në kategorinë e dëshmitarëve të drejtpërdrejtë siç janë dëshmitar-i dëmtuar Z.M, N.C dhe dëshmitarja S.M, ndërsa nga provat rrethore diç janë deklaratat e dëshmitarëve të cilën kanë dëgjuar për ngjarjen drejtpërdrejt nga të dëmtuarit apo rrethanat të tjera, duke konsideruar se pretendimet e mbrojtjes duhet që të refuzohen, ku më tej përshkruan rastin se si u tortura dhe trajtimin çnjerëzor të Z.M, N.F dhe N.C, duke përshkruar më tej gjendjen e fakteve të vërtetuara nga dëshmitë e tyre të dhënë në këtë çështje penale, duke konsideruar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe nuk ka asnjë paqartësi sa i përket gjendjes faktike të përshkruar në aktgjykimin e atakuar. Më tej shton se pretendimet e mbrojtjes lidhur me identifikimin e të pandehurit, prokurori i shtetit konsideron se ky pretendim është i pabazuar në provat materiale, identifikimi i të akuzuarit u bë në përputhje me procedurën e paraparë në dispozitat respektive të KPP-së, shumica e dëshmitarëve të cilën iu nënshtruan këtij procesi e identifikuan të

akuzuarin, ata gjatë shqyrtimit gjyqësor ju treguan se i akuzuari nuk ishte i panjohur, ishte nga i njëjti fshat prandaj e kanë njohur si paraluftës kur punonte si bujk ashtu edhe gjatë kohës së luftës kur ishte bashkuar forcave policore dhe ushtarake serbe. Të dëmtuarit dhe i akuzuari jetonin dhe punonin në të njëjtën zonë dhe kanë pasur mundësi ta shohin dhe ta njohin njëri tjetrin me vitet të tëra. Më tej shton se lidhur me bazat tjera ankimore, duke pasur parasysh me mbrojtja nuk ka paraqitur pretendimet ankimore si pjesë të ankesës, e kemi pasur të pamundur të kuptojmë se ku qëndron baza e pretendimit, andaj ka propozuar si më lart.

Gjetjet e Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, pas analizimit të aktgjykimit të ankimuar së bashku me shkresat e lëndës, e duke vlerësuar pretendimet ankimore si dhe përgjigjen në ankesë, ka gjetur se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të KPPRK-së, të pretenduar në ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, e për të cilat sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, për faktin se dispozitivi i të njëjtit është i paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin e tij e në të cilën nuk janë dhënë arsye të qarta dhe konkrete për faktet vendimtare të kësaj çështje penale, të cilat shkelje kanë kushtëzuar edhe anulimin e detyrueshëm të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit gjen se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar për pikën a) në raport me të dëmtuarin Z.M është në kundërshtim me arsyetimin e tij. Kjo pasi që, si me të drejtë thekson edhe mbrojtja në ankesë, për faktin e goditjes me boks në kokë të dëmtuarit Z.M, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar, fq.31 rreshti i parë, arsyeton se gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike nga vet deklarimi i të dëmtuarit Z.M, ***i cili ka përshkruar në mënyrë kronologjike rrjedhën e ngjarjes dhe veprimet e të akuzuarit dhe ka identifikuar të akuzuarin Ç.J që e kishte goditur në kokë dhe prej të goditurës së tij kishte humbur vetëdijen*** ndërsa në dispozitiv a) të aktgjykimit të ankimuar me të cilën e ka shpallur fajtor të akuzuarin për veprimet inkriminuese përshkruan se, në fq.2 pika a) rreshti 11, ***derisa në një moment i pandehuri i identifikuar me nofkën “D.” e kishte goditur me boks në kokë, me ç’rast i dëmtuari e kishte humbur vetëdijen dhe ishte rrëzuar në tokë duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore të cilat i kishte mjekuar në kushte shtëpiake..***”, andaj rrjedh se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.7 të KPP-së, duke qenë se nuk është hartuar në pajtim me nenin 369 par.7 të KPP-së, shkelje këto të cilat edhe kanë ndikuar në marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë në këtë çështje penale, ku gjykata konform dispozitës së lartë cekur obligohet që në mënyrë të qartë dhe të plotë të paraqet arsye

se cilat fakte dhe për çfarë arsyesh i konsideron të vërtetuara, e që në këtë rast, si është theksuar si më lartë, gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar arsyeton se gjendjen faktike të vërtetuar për këtë pikë (a) pra, se këtë goditje ta kishte shkaktuar i **akuzuari Ç.J**, ndërsa në dispozitiv për këtë fakt-goditje me boks në kokë, përshkruan ti këtë shkaktuar i pandehuri i identifikuar me nofkën “D.”, e që në këtë mënyrë rrjedh qartazi se dispozitivi në pikën a) të aktgjykimit të ankimuar është në kundërshtim me arsyetimin e tij për këtë fakt të kësaj çështje penale andaj aktgjykimi si i tillë juridikisht nuk mund të qëndroj dhe detyrimisht duhej anuluar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit gjen se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.7 e të ndërlidhur me nenin 369 të KPP-së, edhe në dispozitivin për pikën b) pasi që nuk është hartuar konform nenit 364 par.1 nënpar.1.1 të KPP-së, ku në këtë pikë të dispozitivit nuk rezultojnë qartësisht të përshkruara veprimet inkriminuese për të cilat ishte shpallur fajtor i akuzuari në këtë pikë të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Nga shikimi i dispozitivit nën pikën b) në raport me të dëmtuarin Naim Ferati, rezulton përshkrimi se *“rreth datës 15.03.1998, derisa i dëmtuari N.F po pinte kafe në restorantin “Sh.” në G., i shoqëruar nga Sh.K pronar i restorantit, M.H, R.H DHE N.P, kishin shkuar pesë policë serb dhe e kishin kapur për qafe, duke e tërhequr zvarrë e kishin qitur jashtë lokalit dhe që të pestit e sulmojnë fizikisht duke e goditur në pjesë të ndryshme të trupit, prej tyre polici me emrin R.P e kishte goditur disa herë me tytë të automatikut në kokë duke ia mbuluar tërë trupin me gjak, pastaj duke e tërhequr zvarrë e kishin dërguar në stacion të policisë në G., në ato momente ngjarjen e kishte parë i dëmtuari N.C pasi që edhe ai ishte rrahur nga i njëjti grup i policëve, me të dërguar në stacion të dëmtuarin N.F e paralajmërojnë se deri në ora 17:00 do të ekzekutoj dhe vazhdimisht ishte nën shoqërinë e policëve H.K dhe P., pastaj aty kishte ardhur një epror i policisë i quajtur G.V dhe e kishte liruar të dëmtuarin nga stacioni i policisë, pastaj me ndihmën e disa fqinjëve të tij kishte arritur që të shkoj në Spital të Istogut ku e kishte mjekuar doktor XH.A, kurse me datë 28.03.1999 ishte urdhëruar nga policia serbe që ta lëshoj shtëpinë sikur çdo banor tjetër i fshatit dhe ishte nisur për në Shqipëri, ku gjatë rrugës prapë ishin maltretuar dhe plaçkitur nga ana e forcave serbe, ndërsa si pasojë e luftës ka pësuar dëme materiale në vlerë prej/ përfaqësisht/ pesëdhjetë (50.000.00) mijë marka gjermane.”*, pra si rrjedh nga ky përshkrim për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari me aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë (përpos policëve të tjerëve të cekur në emër dhe për veprimet e ndërmarra në drejtim të

dëmtuarit N.F) nuk rezulton se cili ishte veprimi inkriminuese i të akuzuarit në drejtim të shkaktimit të dëmtimit të përshkruara si në këtë pikë, pra pikën (b) të dispozitivit për të dëmtuarin N.F e për të cilën gjykata e shkallës së parë e kishte shpallur fajtor, andaj në këtë drejtim rrjedh se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.2 pika 2.7 të KPP-së, shkelje këto të cilët kanë ndikuar për marrjen e aktgjykimit të ligjshëm dhe të drejtë, prandaj si i tillë detyrimisht duhet anuluar dhe çështja të kthehet në rigjykim.

Kolegji i kësaj gjykate rikujton se gjykata e shkallës së parë është e obliguar që provat e zbatuara në shqyrtimin gjyqësor, ti analizoj një nga një dhe pas vlerësimit të tyre në pajtim me dispozitën e nenit 361 par.1 të KPP-së të nxjerr përfundimin nëse faktet vendimtare të kësaj çështje penale janë të provuara për të cilat është e nevojshme të shpjegohet se pse gjykata i konsideron të besueshme dhe objektive apo se nuk i çmon se janë të tilla pra, gjykata e shkallës së parë është e obliguar ligjërisht të ofroj arsyetim të qartë dhe konkret, lidhur me kundërthëniet, paqartësitë dhe dykuptimësitë kur peshon vlerën provuese të këtyre provave gjë që në këtë rast të kësaj çështje penale gjykata e shkallës së parë nuk ka përmbushur obligimet ligjore nga dispozita e lartë cekur, pasi që nga arsyetimi rrjedh qartazi se gjykata e shkallës së parë përveç përsëritjes së përshkrimeve të deklarimeve të dëshmitarëve nuk rezulton që të ketë analizuar dhe vlerësuar edhe provat dëshmitë e tjera në këtë çështje penale të administruara në shqyrtim gjyqësor, gjë që rrjedhimisht rezulton se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar dhe vlerësuar tërësinë e provave të kësaj çështje penale për të ofruar arsyetim të qartë dhe konkret se cilin fakt dhe për çfarë arsye e ka konsideruar të vërtetuar, duke dhënë shpjegime të qarta nga të cilat ka ardhur në përfundim se i akuzuari i kishte ndërmarrë apo kontribuar me pjesëmarrjen e tij në drejtim të veprës penale e në raport me të dëmtuarit e kësaj çështje penale, për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor nga gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar.

Gjykata e Apelit gjen se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është përshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale ngase në arsyetim nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë arsyet për faktet e vërtetuara me aktgjykimin e ankimuar, për faktin se nga arsyetimi nuk rrjedh qartazi se është bërë një vlerësim i saktësisë së provave gjegjësisht deklaramit kundërthënës dhe dykuptimësh të dëmtuarit por, përkitazi me këtë gjykata është mjaftuar vetëm me përshkrim të deklarimeve konkretisht të dëmtuarit-dëshmitarit N.C në raport me dispozitivin c) ku nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar, fq.25, gjykata përshkruan deklaramin e të dëmtuarit N.C të dhënë në shqyrtim gjyqësor ndërsa në fq.33, për vërtetimin e

gjendjes faktike gjykata mbështetet në deklarin e të dëmtuarit, por lidhur me ngjarjen, prezencën dhe veprimet e të akuzuarit në ditën kritike të datës 15.03.1998 në raport me të dëmtuarin, rrjedh se nuk ka konsistencë në dëshmimin e tij në mes të këtyre deklaratave për të cilat gjykata e shkallës së parë është dashur që në mënyrë të veçantë të vlerësoj këto kundërthënie me qëllim që të vërtetohen në mënyrë të qartë faktet e kësaj çështje penale, andaj në mungesë të arsyetimit të tyre rrjedh se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të ndërlidhur me nenin 369 par.7 të KPP-së.

Nga deklarata e të dëmtuarit N.C të dhënë në prokurori rrjedh se ai ka dëshmuar ndër të tjera se **“edhe më kanë hy dy policë në kerr, u kan Ll. dhe nja që sja di emrin** e kishin pas rreh një egjiptian, shitke cigare në qendër edhe më thanë me na qu te M. , ai e ka pas emrin M., kur jemi nis në drejtim të K., një ven tha, **Ç.J nuk u kan në kerr, policët brenda më thanë me i qu te shpija e M.**” . Ndërsa në deklaratën e tij të dhënë në shqyrtim gjyqësor ndër të tjera i njëjti ka thënë se “15 mars 1998 kur ka qenë duke shkuar me makinë për V. të I. e kanë ndaluar në post bllok në qendër në G. ku ka qenë i vetëm në atë **moment e ka ndal Ll. dhe Ç.J.** Ndërkaq në fq. 33 të aktgjykimit të ankimuar me rastin e paraqitjes së fakteve përmes të cilave është vërtetuar gjendja faktike si në pikën c) ndër të tjera përshkruhet: *“...ishte ndaluar nga ana e policisë dhe dy prej pjesëtarëve të policisë, njëri i njohur me **nofkën Ll. dhe tjetri i paidentifikuar...**”.*

Poashtu në fq.25 të aktgjykimit të ankimuar dëshmitari N.C ndër të tjera ka deklaruar se “...ku personalisht R.P i kishte thënë **që nëse e zënë herën tjetër do ta vrasin**, ku R.P e kërcënoi duke i thënë qetash kurgjo stë kemi ba tjetër herë të mbysim krejt.” ndërsa në fq.33 të po të njëjtit aktgjykim është përshkruar se *“...personi me emrin R.P u ishte drejtuar të akuzuarve **me fjalët “se si po shetiteni me iredinistin”.**”*

Në fq. 25 të aktgjykimit të ankimuar dëshmitari N. sqaroi se **pasi që e kishin rrahur e kishin tërhequr zvarrë përtoke deri në një kafene afër postbllokut...** ndërsa në fq.33 të po të njëjtit aktgjykim është përshkruar se *“...personi me emrin **“Ç.J” e kishte nxjerr nga vetura të dëmtuarin duke e goditur me kondak të armës automatike dhe nga aty e kishte tërheq zvarrë duke e dërguar në një lokal aty afër...**”.* Ndërkaq në deklaratën e tij të dhënë në Prokurori në fq.5 rreshti I fundit ka dëshmuar se: “erdh Ç.J dhe më nxorri prej kerrit, më sjelli me kontakt të automatit dhe prej atyhit u kan një lokal i drunit i tyne i serbve, edhe aty mkanë qu edhe atje mkanë rreh, veç qiky Ç.J kërkush tjetër.

Gjykata e Apelit gjen se, meqenëse aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale edhe gjendja faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë për faktet e theksuara si më lartë e për të cilat është e nevojshme që gjykata e shkallës së parë, të përsëris shqyrtimin gjyqësor për të dëgjuar dëshmitarët e drejtpërdrejtë të ngjarjeve. Andaj, nga arsyet e sipër cekura aktgjykimi i ankimuar juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashtë të anulohet dhe çështja ti kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim, pasi që në kuptim të nenit 403 të KPP-së, Gjykata e Apelit nga konstatimet e bëra lidhur me këto shkelje të lartcekura nga gjykata e shkallës së parë, nuk mund të korrigjoj duke ndryshuar aktgjykimin e kundërshtuar pasi që duhet përsëritur shqyrtimi gjyqësor. Në rigjykim Gjykata e shkallës së parë duhet të veproj në pajtim me vërejtjet e lartcekura, t'i eliminoj të gjitha shkeljet e cekura, t'i administroj të gjitha provat, dhe të njëjtat t'i vlerësoj në pajtim me dispozitën e nenit 369 të KPP-së, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta të ligjshme e të bazuara në provat e administruara e mandej të merr vendim të drejtë dhe ligjor.

Vazhdimi i paraburgimit e të akuzuarit Ç.J u bazua në kuptim të nenit 402 par.5 të KPPK-së, e deri në një vendim tjetër që do ta merr gjykata e shkallës së parë.

Nga arsyet e sipër cekura dhe në bazë të nenit 402 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
DEPARTAMENTI SPECIAL
APS.nr.45/2024, datë 04.10.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale,

Anëtarët e kolegjit,

Kryetar i kolegjit,

Gresë Latifi

Vaton Durguti

Burim Ademi

Kreshnik Radoniqi